



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr. 1

Prishtinë, më 23.12.2014 ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani kryetar, Salih Morina, Jelena Bontič, Bekim Haxhiu, Shpejtim Bulliqi, Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyqi dhe Mufera Sinik.

Në mbledhje morën pjesë: zyrtarë nga presidenca, përfaqësues të OSCE-së dhe zyrtarët për media të Kuvendit.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend dite

1. Mbledhja konstituive e Komisionit.

Kryetari i Komisionit Nait Hasani, në fillim tha se ky takim ka më tepër karakter njohës me anëtarët e Komisionit si dhe me natyrën e punës së Komisionit.

Si kryetar i Komisionit u zotua se bashkërisht me anëtarët e komisionit do të kontribuon në shërbim të miratimit të ligjeve dhe realizimit të detyrave në fushat që i mbulon Komisioni. Si çështje me rëndësi për këtë Komision është bashkëpunimi me ministrinë përkatëse, dhe aspektet në fushëveprimtarë të Komisionit.

Salih Morina tha se duhet përpiluar një plan pune në bazë të të cilit do të punohet sipas prioritetëve kur kihet parasysh rëndësinë që ka ky Komision duke i mbuluar dy ministrinë mjaft të rëndësishme.

Jelena Bontiq në diskutimin e saj tha se do të angazhohet bashkërisht në pajtim me rregullat e punës duke pasur parasysh rendësin e sistemit arsimor në përgjithësi.

Teuta Haxhiu tha se bashkëpunimi ne Komision duhet te jete prioritet i te gjithëve duke pasur parasysh se sistemi arsimor është ne degradim e sipër, ajo përmendi sidomos problemet ne arsimin e larte.

Myfera Shinik gjithashtu premtoi bashkëpunim me anëtarët e komisionit ne këtë legjislature.

Ismail Kurteshi tha se fushat qe i mbulon Komisioni kërkojnë angazhim dhe bashkëpunim i cili shpreson se nuk do te mungoje me qëllim që të kontibohet ne përmirësimin e sistemit arsimor.

Bekim Haxhiu tha se Komisioni prek dy fushat kryesore qe kane te bëjnë me rininë dhe arsimin, kërkoj qe te shqyrtohet pjesa e buxhetit per këto dy fusha, si dhe ne mbledhjen e radhës të ftohen ministrat e resorëve përkatës në mënyrë qe të diskutohet per prioritetet.

Shpejtim Bulliqi ne diskutimin e tij shprehi gatishmërinë e tij për të dhënë kontributin e tij në fushat që mbulon Komisioni si dhe theksoi mundësinë e ngritjes së buxhetit për arsimin parafillor ne mënyrë qe të rritet kuota e punëtorëve për këtë nivel arsimor.

Shukrije Bytyqi, gjithashtu premtoi bashkëpunim ne fushat që mbulon Komisioni, ndërsa sa i përket Buxhetit të vitit 2015 kërkoj që mësimdhënësve të viteve të 90 –ta t’i njihet stazhi i punës dhe per këtë të ndahet një pjesë e buxhetit pr këtë kategori.

Nait Hasani, në vijim diskutoi lidhur me kohën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Komisionit, dhe anëtarët e Komisionit u pajtuan që mbledhjet e rregullta të mbahen ditën e mërkurë në orën 11,00.

Në vijim, duke pasur parasysh kohen e shkurtër per shqyrtimin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 Komisioni në bazë të nenit 57, paragrafi 3, 4 dhe 5 të Rregullores së Kuvendit, vendosi njëzëri që Komisionit për Buxhet dhe Financa t’ia paraqesë amendamente si në vijim:

Amendamenti 1

Në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në kategorinë e Investimeve Kapitale të bëhen ndryshimet si në vijim:

- Nga kategoria Investimet Kapitale kodi 14237 ”Blerja e automjeteve për Universitetin e Prizrenit” të zvogëlohet nga 50,000 (Pesëdhjetëmijë euro) në 15.000 (Pesëmbëdhjetë mijë euro).

Shuma e mbetur prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë euro) të bartet në projektin e ri **”Pajisje për salla dhe laboratorë për studentë”**.

Amendamenti 2

Në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në kategorinë e Investimeve Kapitale të bëhen ndryshimet si në vijim:

- Nga kategoria Investimet Kapitale kodi 14048 "Blerja e automjeteve për Universitetin e Gjilanit" të zvogëlohet nga 30,000 (Tridhjetëmijë euro) në 15.000 (Pesëmbëdhjetëmijë euro).

Shuma e mbetur prej 15.000 (Pesëmbëdhjetëmijë euro) të bartet në projektin e ri **"Pajisje për salla dhe laboratorë për studentë"**.

Amendamenti 3

Në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në kategorinë e Investimeve Kapitale të bëhen ndryshimet si në vijim:

- Nga kategoria Investimet Kapitale kodi 14055 "Blerja e automjeteve për Universitetin e Gjakovës" të zvogëlohet nga 30,000 (Tridhjetëmijë euro) në 15.000 (Pesëmbëdhjetëmijë euro).

Shuma e mbetur prej 15.000 (Pesëmbëdhjetëmijë euro) të bartet në projektin e ri **"Pajisje për salla dhe laboratorë për studentë"**.

Amendamenti 4

Në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në kategorinë e Investimeve Kapitale të bëhen ndryshimet si në vijim:

- Nga kategoria Investimet Kapitale kodi 14054 "Blerja e automjeteve për Universitetin e Mitrovicës" të zvogëlohet nga 30,000 (Tridhjetëmijë euro) në 15.000 (Pesëmbëdhjetëmijë euro).

Shuma e mbetur prej 15.000 (Pesëmbëdhjetëmijë euro) të bartet në projektin e ri **"Pajisje për salla dhe laboratorë për studentë"**.

Amendamenti 5

Në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në kategorinë e Investimeve Kapitale të bëhen ndryshimet si në vijim:

- Nga kategoria Investimet Kapitale kodi 14-3071 "Stadiumet ndihmëse të futbollit" të zvogëlohet nga 800,000 (Tetëqind mijë euro) në 400.000 (Katërqind mijë euro).

Shuma e mbetur prej 400.000 (Katërqind mijë euro) të bartet në projektin e ri **"Renovimi i Fazës së II-të të Stadiumit Olimpik Adem Jashari"** në Mitrovicë.

Mbledhja përfundoi në ora 11:35.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani**